



**RAPORT MONITORIMI GJASHTË MUJOR  
MBI EKZEKUTIMIN E MASAVE DHE DËNIMEVE  
PËR TË MITURIT NË QENDRËN KORREKTUESE NË LIPJAN**

**KOSOVË 2016**

RAPORT MONITORIMI GJASHTË MUJOR MBI EKZEKUTIMIN E MASAVE DHE DËNIMEVE  
PËR TË MITURIT NË QENDRËN KORREKTUESE NË LIPJAN

**Autorët:**

Donjeta Kelmendi

Klevis Vaqari

Valdrin Dervishaj

© Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve të KOMF.

KOMF:

22 organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të përpjekjeve të tyre në mbrojtjen e fëmijëve, krijuan Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve me mision mbrojtjen, respektimin, avancimin e mirëqenies dhe të drejtave të tyre.

Organizatat anëtare të KOMF janë:

Associazione Amici dei Bambini, Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim – ASTRA, Action for Mothers and Children, Balkan Sunflowers Kosova, Iniciativa 6, Kosovo Education for Sustainable Development, Kosovo Rehabilitation Center for Torture Victims KRCT, Organizata Rinore Akti, One To One Kosova – Qendra e Këshillimit për Familje, One to One Children’s Fund, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara FIT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë, Terre des hommes, VoRAE dhe World Vision.

**RAPORT MONITORIMI  
GJASHTË MUJOR MBI EKZEKUTIMIN  
E MASAVE DHE DËNIMEVE PËR TË MITURIT  
NË QENDRËN KORREKTUESE  
NË LIPJAN**

## Falenderime

Në emër të misionit të përbashkët për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, Koalicioni i OJQ–ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF falenderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij raporti monitorues, që ka si qëllim avancimin e mbrojtjes së të drejtave të të miturve me masa dhe dënime në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Femra në Kosovë.

KOMF falenderon gjithashtu ata që u përfshinë në këtë analizë: të miturit me masa dhe dënime, stafin e Qendrës Korrektuese për të Mitur dhe Femra, Agjensionin Korrektues të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë dhe organizatat anëtare të KOMF.

Një falenderim i veçantë shkon po ashtu për grupin punues të KOMF.

Me respekt,  
Presidenti i KOMF



## Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive .....	5
Objektivat.....	8
Metodologjia .....	8
Statistikat për të miturit në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Femra .....	10
Praktika e zgjatjes së paraburgimit.....	11
Vonesat në ekzekutimin e masave dhe dënimeve .....	11
Ekzekutimi i masës edukuese korrektuese .....	12
Të miturit e dënuar dhe të miturit e paraburgosur në Qendrën Korrektuese.....	14
Vizitat e gjyqtarëve për të miturit në QKL .....	15
Mungesa e programeve të standardizuara individuale për të miturit.....	16
Programet për rehabilitim dhe reintegrim .....	17
Procesi arsimor për të miturit në Qendrën Korrektuese .....	18
Kalueshmëria e të miturve në sistemin arsimor në QKL .....	20
Mungesa e edukatorëve dhe e programeve edukative .....	20
Kujdesi shëndetësor për të miturit në qendrën edukative korrektuese .....	21
Organizimi i stafit shëndetësor .....	21
Kërkesat e të miturve për shërbime shëndetësore.....	22
Lista esenciale e barnave.....	23
Niveli i kënaqshmërisë së të miturve me shërbimet shëndetësore dhe psikologjike	23
Nevoja për ngritje të kapaciteteve .....	24
Shërbimi psikologjik në QKL.....	24
Referimi i rasteve për trajtim.....	25
Aktivitetet e lira ekstrakurrikulare dhe sportive .....	26
Biblioteka .....	27
Gjendja psiko sociale e të miturve në QKL.....	27
Kushtet higjienike .....	28
Vizitat e familjeve për të miturit në QKL.....	28
Pushimet e të miturve.....	29
Qëndrimi i të miturve femra në të njëjtin pavion me femrat e rritura.....	29
Dhuna e përdorur si mjet disiplinimi .....	30
Sistemi i ankesave në QKL .....	31
Organizimi i stafit në QKL.....	31
Perceptimi i stafit të QKL për institucionin e ri edukativo korrektues.....	32
REKOMANDIME .....	34

## Përmbledhje ekzekutive

KOMF ka monitoruar zbatimin e masave edukative / institucionale; dërgimin në institucionin edukativo – korrektues dhe burgimin për të mitur, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të arritur në mes të Ministrisë së Drejtësisë (tutje në tekst si MD) dhe Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (tutje në tekst si KOMF).<sup>1</sup> Ky raport publikon të gjeturat e monitorimit gjatë periudhës janar – qershor 2016.

Raporti i KOMF ka për qëllim kryesor prezantimin e gjendjes së ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, bazuar në gjetjet e KOMF gjatë monitorimit. Po ashtu, raporti mbi bazën e të gjeturave ofron rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, pergjegjësive ligjore dhe atyre institucionale si dhe gjendjes aty ku vërehen mangësi.

Fushat kryesore në të cilat është fokusuar monitorimi i KOMF janë: Kohëzgjatja e paraburgimit; Shqiptimi i masës edukuese korrektuese; Vizitat e gjyqtarëve; Programet individuale; Edukatorët dhe grupet edukative; Procesi arsimor; Shërbimet shëndetësore; Shërbimi psikologjik dhe social; Të drejtat e të miturve; Trajtimi i të miturve brenda Qendrës Korrektuese në Lipjan (tutje në tekst si QKL); Aftësimi profesional; Rehabilitimi dhe reintegrimi; Sistemi i ankesave; Organizimi i stafit.

Gjatë periudhës gjashtë mujore janar – qershor 2016, numri i të miturve që kanë marrë trajtim në QKL ka qenë gjithsej 92 të mitur. Nga numri i përgjithshëm i të miturve, 11 prej tyre kanë qenë të dënuar, 40 me masë edukative korrektuese si dhe 41 të mitur të paraburgosur.<sup>2</sup>

Stërzgjatja e paraburgimit është evidentuar. Gjatë periudhës monitoruese një të mituri i është zgjatur periudha e paraburgimit. Afati i paraburgimit për të mitur prej gjashtë muajve me mundësi zgjatjeje për më shumë se një vit është në kundërshtim me standartet, me praktikat ndërkombëtare dhe interesin më të mirë të të miturve.<sup>3</sup> Për më keq, paraburgimi nuk kalkulohet në kohëzgjatjen e masës.

Gjatë periudhës monitoruese ka vazhduar praktika e shqiptimit të masave mbi masë. Numri i të miturve që u janë shqiptuar dy masa brenda gjashtë muajve është tre të mitur. Vizitat e gjyqtarëve nuk janë mbajtur çdo gjashtë muaj, duke rezultuar me vetëm katër vizita të gjyqtarëve dhe duke nënkuptuar shkelje të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (tutje në tekst si KDM).

Sipas KDM, institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Të miturit me masë edukative janë mbajtur në institucion të tipit të mbyllur, që nënkupton shkelje të dispozitave të KDM, rrjedhimisht shkelje të rëndë të të drejtave themelore të tyre. Rutina nuk dallon në mes të të miturve në masë edukative dhe atyre të dënuar duke qëndruar në mospajtim me vendimin e gjykatës.

Të miturit në QKL nuk trajtohen në bazë të ndonjë programi individual të standartizuar. Programet

1 KOMF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë më 16 dhjetor 2015, për të bërë monitorimin e zbatimit të ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve nga Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës

2 Statistika të nxjerra nga QKL në Lipjan

3 Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor, 1990

individuale që do të duhej të hartoheshin nga ekipi multidisiplinar i cili punon me të miturit, nuk ekzistojnë. Dokumenti me të cilin punon punëtori social, është vetëm një pjesë e caktuar e një programi të mirëfilltë individual.

Gjatë peridhës monitoruese janë konstatuar vështirësi të shumta në mbarëvajtjen e sistemit arsimor, si në aspektin e organizimit të procesit arsimor ashtu edhe në atë të cilësisë së mësimdhënies dhe deri të mos-mbajtja e procesit mësimor për të gjitha lëndët në planprogramin mësimor, duke rezultuar në nivel të dobët arsimor. Edhe pse e paraparë me ligj, është konstatuar mungesë totale e edukatorëve dhe e programeve edukative, gjë që evidentohet si një mungesë mjaft domethënëse në ambientet e QKL e cila reflektohet në të gjitha sferat e trajtimit të të miturve për të arritur rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre.

Të miturit në QKL ndjekin dy programe rehabilitimi.<sup>4</sup> Megjithatë, këto dy programe janë të pamjaftueshme për të përmbushur funksionet që një qendër korrektuese duhet të ketë dhe programet që ajo duhet të aplikojë me të mitur, sidomos ata nën masa edukative. Një mangësi tjetër e evidentuar në sferën e rehabilitimit dhe reintegrimin të këtyre të miturve është mungesa e punës me familjen.

Të gjithë të miturit e intervistuar rrëfejnë se kanë parë, kanë dëgjuar ose kanë qenë vetë protagonistë të episodeve të ushtrimit të dhunës brenda ambienteve të QKL. Të gjithë të miturit poashtu kanë shprehur dukshëm një mungesë të përgjithshme të besimit për të shprehur shqetësimet apo pakënaqësitë e tyre, duke rezultuar me vetëm dy ankesa brenda gjashtë mujorit.

Ndër mangësitë në QKL është qëndrimi i të miturve femra në të njëjtin pavion me femrat e rritura, të cilat janë të dënuara për vepra nga më të ndryshmet duke përfshirë vrasjen, prostitucionin dhe të tjera. Kjo përbën shkelje flagrante të të drejtave të të miturve dhe i dëmton ato, pasi qëndrimi në një ambient me femra të rritura të dënuara është krejtësisht i papërshtatshëm për to, jashtë kontekstit të moshës, zhvillimit dhe pjekurisë konjitive të të miturve.

Konstatohet numër i madh i zyrtarëve korrektues dhe numër i vogël i stafit profesionist. Në QKL janë të punësuar 135 zyrtarë korrektues me uniformë, përderisa 27 janë staf civil, përfshirë drejtorin e QKL.<sup>5</sup> Organizimi aktual i QKL ka synim primar sigurinë (pengimin e ikjes së të miturve) duke lënë pas dore punën në rehabilitim, edukim dhe reintegrim të të miturve, që përbën edhe qëllimin e dhënies së masave. Për më tepër zyrtarët korrektues me uniformë nuk kanë pasur asnjëherë trajnime rreth trajtimit të të miturve.

Duke konsideruar rrethanat në të cilat ekzekutohen masat edukative në QKL, ky institucion nuk i përmbush parakushtet për arritjen e qëllimit për të cilin është krijuar, përkatësisht rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve me masa dhe dënime, për më tepër shkel të drejtat themelore të të miturve.

Duke qenë se qendra e re korrektuese është në prag të funksionalizimit, një varg defektesh të sistemit aktual mund të eliminohen. Duke mos mohuar për asnjë moment punën e cila bëhet nga institucionet publike, problematikat e identifikuar nga monitorimi, janë analizuar nga grupi punues dhe janë shoqëruar me rekomandime konkrete në përputhshmëri me interesin më të mirë të të miturve, standartet ndërkombëtare dhe kontekstin e Kosovës, të cilat synojnë përmirësimin e ekzekutimit të masave edukative dhe dënimeve për të mitur për të përmbushur qëllimin e dhënies së tyre.

4 Terapia e Grupit dhe Programi për Menaxhimin e Zemërimit EQUIPE

5 Intervistë me drejtorin e QKL



## Objektivat

Raporti për monitorimin e zbatimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve në konflikt me ligjin, ka për objektiv kryesor prezantimin e gjendjes mbi zbatimin e masave dhe dënimeve ndaj të miturve për gjashtë muajt e fundit brenda Qendrës Edukative Korrektuese. Po ashtu, raporti mbi bazën e të gjeturave mëton të ofrojë rekomandime për përmirësimin e gjendjes aty ku vërehen mangësi. Të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet për përmirësimin e gjendjes janë të mbështetura në frymën e dokumenteve ligjore ndërkombëtare dhe vendore të cilat promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe interesin më të mirë të të miturve.<sup>6</sup>

## Metodologjia

Metodologjia e punimit të raportit është bazuar në mbledhjen e të dhënave të bazuara në metodën cilësore dhe në analizën teorike të literaturës relevante dhe legjislacionit primar dhe sekondar, ku përfshihen:

- a. Analiza e legjislacionit;
- b. Analiza e dokumenteve dhe e literaturës relevante;
- c. Intervistat gjysmë të strukturuar me përfaqësues të Qendrës Korrektuese, fëmijët, dhe shoqërinë civile.

Intervistat janë kryer me përfaqësues të Qendrës Korrektues për të Mitur dhe Femra, me të miturit me masa dhe dënime në QKL si dhe me Agjensionin Korrektues të Kosovës.

Intervistat me të miturit në masa, të dënuar, të paraburgosur, staf dhe të tjerë janë kryer si në vijim:

- Të miturit me masa (8 të mitur);
- Të miturit e dënuar (6 të mitur);
- Të miturit e paraburgosur (1 i mitur);
- Punëtori Social;
- Psikologjia;
- Koordinatorin e programeve;
- Arsimitarët në QKL (8);
- Stafi shëndetësor (5);
- Udhëheqësit e pavioneve (2);
- Zyrtarët Korrektues;
- Drejtori i QKL.

*Monitorimi është bazuar në indikatorët si vijon:*

<sup>6</sup> Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria Të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/113, të datës 14 dhjetor, 1990

- Kohëzgjatja e paraburgimit;
- Ekzekutimi i masës edukuese korrektuese;
- Vizitat e gjyqtarëve;
- Programet individuale;
- Edukatorët dhe grupet edukative;
- Procesi arsimor;
- Shërbimet shëndetësore;
- Shërbimi psikologjik dhe social;
- Të drejtat e të miturve;
- Trajtimi i tyre brenda QKL;
- Aftësimi profesional;
- Rehabilitimi dhe reintegrimi;
- Sistemi i ankesave;
- Organizimi i stafit.


## Statistikat për të miturit në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Femra

Gjatë periudhës gjashtë mujore janar – qershor 2016, numri i të miturve në QKL ka qenë gjithsej 95 të mitur, prej tyre 92 të gjinisë mashkullore dhe 3 të gjinisë femërore. Nga numri i përgjithshëm i të miturve, 11 të mitur janë të dënuar me burg për të mitur, me masë edukative korrektuese 40 të mitur dhe në paraburgim 41 të mitur.<sup>7</sup>

Lloji i Masës/Dënimit	Nr i të miturve
Paraburgim	41
Masë Edukative Korrektuese	40
Të Dënuar me Burg	11
<b>Total</b>	<b>92</b>

### Nr i të miturve sipas masës/dënimit


■ Paraburgim ■ Masë Edukative Korrektuese ■ Të dënuar me Burg



veçantë është fakti se të miturit e moshës 14-16 vjeçare përbëjnë numrin më të madh të të paraburgosurve me gjithsej 23 raste, ndërkohë që vetëm katër raste të kësaj grupmoshe janë në masa edukative korrektuese (Shih Graf 1). Të miturit e grupmoshës 16-18 vjeçare përbëjnë numrin më të madh të të miturve me masa edukative korrektuese, me gjithsej 22 raste (Shih Graf 1). Ndërkohë janë vetëm dy raste të të miturve të dënuar, të moshës 16-18 vjeçare. Numri më i madh i të miturve në QKL i takojnë moshës 16-18 vjeçare.

## Të miturit në QKL sipas moshës

■ 16-18 vjeç ■ 14-16 vjeç



Të miturit që gjenden në QKL, ndaj të cilëve janë shqiptuar dënimet, masat edukativo-korrektuese ose janë në paraburgim, kryesisht ngarkohen për lloje të ndryshme të veprave, si: vjedhje e rëndë dhe vjedhje, vrasje dhe tentim vrasje, grabitje, lëndime trupore, keqpërdorime seksuale, rrezikim trafiku e të tjera.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Statistika të nxjerra nga QKL në Lipjan

<sup>8</sup> Intervistë me drejtorin e QKL

## Praktika e zgjatjes së paraburgimit

Sipas KDM, Neni 66, paragrafi 2, i mituri mund të mbahet në paraburgim me aktvendim të gjyqtarit për të mitur për një periudhë maksimale prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur ai është arrestuar. Paraburgimi i të miturit mund të vazhdohet vetëm nga kolegji për të mitur i gjykatës kompetente, për një periudhë shtesë deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.<sup>9</sup> Neni 68 i po këtij Kodi, specifikon që përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj nga dita e arrestit.<sup>10</sup>

Gjatë periudhës monitoruese, një (1) të mituri i është zgjatur periudha e paraburgimit. Sipas stafit të QKL dhe të miturve ndodh të vonohen procedurat, për dallim nga Drejtori që thekson që nuk ka vonesa si në të kaluarën.<sup>11</sup> Si pasojë e presionit të bërë mbi gjykatat numri i rasteve të tilla është zvogëluar, megjithatë zgjatja e paraburgimit është e evidente edhe më tutje.

Afati i paraburgimit për të mitur, prej 6 muajve me mundësi zgjatjeje deri në një vit, është në kundërshtim me standartet dhe praktikat ndërkombëtare. Kjo bëhet dhe më shumë e papranueshme për të miturit pasi që paraburgimi nuk kalkullohet në kohëzgjatjen e masës.

KOMF vlerëson që afati 6 muaj me mundësi zgjatjeje dhe për 6 muaj të tjerë duhet të ndryshohet duke përcjellë praktikata e vendeve me sistem më të avancuar të drejtësisë për të mitur, ku paraburgimi mund të zgjasë maksimumi 3 muaj. Shtetet në Evropë, duke përfshirë edhe vendet e rajonit, kanë vendosur afatin e paraburgimit për të mitur deri në maksimum tre muaj.

- KOMF rekomandon që në plotësim ndryshimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur afati i paraburgimit të shkurtohet maksimumi në tre muaj si dhe të parashihen dispozita ligjore për kalkulimin (matjen) e paraburgimit në kohëzgjatjen e masës.

## Vonesat në ekzekutimin e masave dhe dënimeve

Periudha kohore ndërmjet pranimit të urdhrimit për paraqitje në institucionin korrektues dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më e shkurtër se tetë ditë dhe më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë.<sup>12</sup> Shtyrja e ekzekutimit të dënimit bëhet me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri ditëve nga pranimi i urdhrimit për mbajtjen e dënimit, në rast sëmundjeje të rëndë akute të personit të dënuar ose vdekje të bashkëshortit/es së tij/saj, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit ose prindit adoptues.<sup>13</sup> Shtyrja bëhet në pajtim me ligjin.<sup>14</sup> Në çdo rrethanë tjetër, shtyrja e ekzekutimit të masës së dënimit është e ndaluar.

9 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 66, paragrafi 2; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>.

10 Kodi i Drejtësisë për të Mitur; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>.

11 Intervistë me drejtorin e QKL

12 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Neni 15(2)

13 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Neni 20 (1) Personi i dënuar e parashtron kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri ditëve nga pranimi i urdhrimit për mbajtjen e dënimit. (2) Nëse sëmundja e rëndë akute e personit të dënuar ose vdekja e bashkëshortit të tij, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit ose prindit adoptues paraqitet pas kalimit të periudhës prej tri ditëve, kërkesa mund të parashtrohet deri në ditën kur personi i dënuar duhet të paraqitet për mbajtjen e dënimit. (3) Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit duhet të përmbajë arsyet e shtyrjes, provat që mbështesin shtyrjen dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet shtyrja.

14 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Neni 6

Numri i rasteve të vonuara në ekzekutimin e dënimeve me masa edukuese korrektuese kur të miturit janë sjellë në vuajtjen e masës pas moshës madhore, është i madh. Shumë shpesh ndodh që të shtyhet ekzekutimi i masës si pasojë e vonesave në procedura gjyqësore dhe për pasojë pas limitit të moshës 23 vjeçare të realizohet transferimi në qendra të tjera ku vuajnë dënimin të rriturit.<sup>15</sup>

- KOMF rekomandon gjykatat për ndryshimin e praktikës së tillë sepse një gjë e tillë dëmton në masë të madhe risocializimin dhe reintegrimin e atyre të miturve që tashmë kanë mbërritur moshën madhore dhe duhet të transferohen.

## Ekzekutimi i masës edukuese korrektuese

Të gjeturat gjatë procesit të monitorimit lidhen si me praktikën gjyqësore të shqiptimit të masës por edhe në mënyrën e ekzekutimit të masës edukuese korrektuese.

Praktika e gjyqtarëve në shqiptimin e masës mbi masë

Sipas KDM, për vepra penale në bashkim, gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet.<sup>16</sup> Sipas dispozitës së njëjtë, një masë e tillë po ashtu zbatohet në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të burgimit për të mitur.<sup>17</sup>

Gjatë periudhës monitoruese është konstatuar një praktikë e dëmshme për të miturit, e cila bie ndesh me KDM. Këtu bëhet fjalë për shqiptimin e masave mbi masa, përkatësisht raste ku pa përfunduar një masë gjykata ka shqiptuar edhe një masë tjetër. Në këtë rast shqiptimi i masës mbi masë për të miturin (dy masave edukuese-korrektuese) ndikon negativisht duke e dëmtuar reintegrimin dhe risocializimin e të miturit. Numri i të miturve që u janë shqiptuar dy masa brenda gjashtë mujorit është tre.

Përpos këtyre efekteve negative, aplikimi i masave të dyfishta ndikon në uljen e besimit tek të miturit për sistemin korrektues dhe sistemin e drejtësisë duke e parë atë si pengesë e jo ndihmë në risocializimin dhe reintegrimin e tyre. Të miturit të cilët kanë marrë dhe një masë pa përfunduar masa në ekzekutim, kanë filluar të shfaqin sjellje jo të mira. Një i mitur shprehet “ku është qëllimi që unë sillem mirë”.<sup>18</sup>

Të miturit e intervistuar shfaqin mospajtim të plotë me këtë praktikë duke treguar që u pengon në rikthimin në jetën normale duke ua zgjatur qëndrimin në QKL. Një nga të miturit thekson se “pas kësaj mase që kam pasur jemi pajtuar me prindin që të filloj punën në punëtorinë familjare si mekanik, mirëpo masa e re më ka zhgënjyer sepse tash edhe për pesë vite të tjera do të jem këtu”.<sup>19</sup>

15 Intervistë me Drejtorin e QKL

16 Kodi i Drejtësisë për të Mitur neni 37; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>.

17 Ibid.

18 Intervistë me të miturin NN, QKL

19 Intervistë me të miturin NN, QKL

- KOMF rekomandon fuqishëm gjykatat që bazuar në dispozitat e KDM si dhe në interesin më të mirë të të miturve të mos praktikojnë shqiptimin e masave të dyfishta.

## **Mbajtja e të miturve me masë edukative në institucion të tipit të mbyllur, përbën shkelje të dispozitave të KDM dhe shkelje të rëndë të të drejtave themelore të tyre.**

KDM bën dallimin në mes të të miturve me masë edukative dhe atyre të dënuar me burgim. Sipas KDM, masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.

Gjatë periudhës monitoruese gjashtë mujore, të miturit me masë edukative janë mbajtur në institucion të tipit të mbyllur, që nënkupton shkelje të dispozitave të KDM, rrjedhimisht shkelje të rëndë të të drejtave themelore të tyre. Monitorimi i KOMF ka identifikuar se të gjithë të miturit me masë edukative, qëndrojnë në një objekt (pavion) të tipit të mbyllur. Objekti ka dy kate. Mesatarja e të miturve në këtë pavion sillet prej 35 të mitur, ku mesatarisht tre apo katër të mitur janë të vendosur në një dhomë.

Pavioni (objekti) për të miturit me masë edukative korrektuese është tërësisht i rrethuar me tela gjëmbor deri në katër metra të lartë dhe i mbyllur me një derë elektrike e cila mund të hapet vetëm nga zyrtarët korrektues. Të miturit nuk kanë të drejtë që të dalin nga ky pavion, përveç në rastet kur kanë kohën e shëtitjes, sportit, ndjekjes së shkollës, programit rehabilitues, bërjes së punës (nëse kanë leje) dhe nëse ata kanë nevojë për trajtim shëndetësor.

Për cilindo nga aktivitetet e lartpërmendura, dera elektrike hapet nga zyrtarët korrektues dhe të miturit shoqërohen nga zyrtarët korrektues deri tek ambientet e tjera të QKL, ku mbahen këto aktivitete. Shëtitjet jashtë pavionit, organizohen në orare të veçanta, në kohë të kufizuar prej një ore gjatë paradites dhe një ore gjatë pasdites. Shëtitjet bëhen vetëm para pavionit të të miturve me masë edukative, në një sipërfaqe të vogël katrore. Përtej këtij orari është rreptësisht e ndaluar dalja nga pavioni, i cili mbyllet me një derë elektrike. Vlen të theksohet që e gjithë hapësira e QKL është e rrethuar me tela të lartë gjëmbor dhe masa fizike të sigurisë.

Poashtu, programi aktual për të miturit me masë edukative në QKL, nuk është program i përshtatur për të përmbushur qëllimin e dhënies së masave edukative, por më shumë ngjason me një program të institucioneve të tipit të mbyllur.

Të miturit nuk kanë të drejtën të vijojnë arsimin në shkolla publike jashtë qendrës korrektuese, edhe pse dispozitat ligjore të KDM nuk e pengojnë një gjë të tillë. Ndër të tjera, brenda pavionit konstatohet prezenca e një numri të madh të oficerëve me uniformë dhe në të njejtën kohë mungesa totale e stafit profesional (edukatorë, punëtorë socialë, psikologë, instruktorë profesional, këshilldhënës).

Rutina nuk dallon në mes të të miturve me masë edukative dhe atyre të dënuar duke qëndruar në mospajtim me vendimin e gjykatës. Përderisa kushtet fizike të parapara për të miturit me masë edukative janë më të këqija se kushtet për të miturit e dënuar.

- Rekomandohet zbatimi i dispozitave të KDM në pajtim me Rregullat e Havanës, duke krijuar objekt të tipit gjysmë të hapur dhe të hapur për të miturit me masë edukative. Objekti i tillë duhet të ketë kushte sigurie minimale apo të jetë fare pa to. Numri i të miturve në objekt duhet të jetë sa më i vogël që të jetë e mundur.
- Rekomandohet që të miturit të lejohen të vijojnë mësimin jashtë institucionit edukativ korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.
- Rekomandohet që të miturit të kenë mundësi të kryerjes së punës me shpërblim, në rast se është e mundur në komunitet, si plotësim i trajnimit profesional për rritjen e mundësive për punësim adekuat pas kthimit në familje dhe komunitet.
- Rekomandohet nxjerrja e një akti nënligjor nga MD, lidhur me programin për të miturit me masë edukative në institucion të tipit të hapur dhe gjysmë të hapur.

## **Të miturit e dënuar dhe të miturit e paraburgosur në Qendrën Korrektuese**

Sipas KDM, sistemi i drejtësisë për të mitur garanton që gjithë të miturit të cilët janë të privuar nga liria si pasojë e kryerjes së veprës penale të trajtohen me humanizëm për hir të dinjitetit e të personalitetit të tyre njerëzor, dhe me këtë rast duke marrë parasysh nevojat personale të moshës së tyre.<sup>20</sup>

Qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, zhvillimin e aftësive profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin. Gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili e ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuat për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.<sup>21</sup>

Të miturit e dënuar në qendrën korrektuese qëndrojnë në një pavion të tipit të mbyllur, të ndarë në kate me të miturit e paraburgosur. Pavioni (objekti) për të miturit e dënuar dhe paraburgosur është tërësisht i rrethuar me tela gjëmbor deri në katër metra të lartë. Objekti ka dy kate dhe një sipërfaqe të vogël me një derë elektrike e cila mund të hapet vetëm nga zyrtarët korrektues. Mesatarja e të mituve në këtë pavion sillet prej 10 të mitur, ku mesatarisht tre apo katër të mitur janë të vendosur në një dhomë. Shëtitjet dhe daljet jashtë pavionit, organizohen në orare të veçanta, në kohë të kufizuar prej një ore gjatë paradites dhe një ore gjatë pasdites. Të miturit nuk kanë të drejtë që të dalin nga ky pavion, përveç në rastet kur kanë kohën e shëtitjes, sportit, ndjekjes së shkollës, programit rehabilitues dhe nëse ata kanë nevojë për trajtim shëndetësor.

<sup>20</sup> Neni 3, Kodi i Drejtësisë për të Mitur

<sup>21</sup> Neni 33, Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Shkelje është edhe fakti se të miturit e paraburgosur qëndrojnë në një objekt me të miturit e dënuar. Drejtori i QKL, thekson se për shkak të pamundësive janë të detyruar t'i mbajnë në një objekt. Rutina nuk dallon në mes të të miturve të dënuar dhe të miturve me masë edukative. Përderisa kushtet fizike të parapara për të miturit e dënuar dhe të paraburgosur janë më të mira se sa për të miturit me masë edukative.

- Rekomandohet zbatimi i dispozitave të KDM në pajtim me Rregullat e Havanës, duke krijuar objekt të tipit gjysmë të hapur për të miturit e dënuar dhe hartimin e një programi të mirëfilltë për rehabilitimin, edukimin e të miturit, zhvillimin e aftësive profesionale dhe zhvillimin e duhur personal.
- Rekomandohet ndarja e objektit për të miturit e dënuar dhe ata të paraburgosur.

## Vizitat e gjyqtarëve për të miturit në QKL

Sipas KDM, çdo gjashtë (6) muaj, gjyqtari për të mitur duhet të vizitojë të miturit e vendosur në institucion apo qendër, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarët e përfshirë drejtpërdrejtë në ekzekutimin e masës edukative institucionale si dhe pas shqyrtimit të shënimeve të institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme.<sup>22</sup>

Gjyqtari për të mitur menjëherë e informon shërbimin sprovues kompetent dhe institucionin ose qendrën që ekzekuton masën edukative institucionale për çfarëdo të mete apo vërejtjeje tjetër. Pas marrjes së informatave të tilla, shërbimi sprovues menjëherë bën kontrollin adekuate, ndërmerr masa për korrigjimin e paligjshmërive dhe parregullsive, dhe e informon gjykatën kompetente për veprimet e ndërmarra.<sup>23</sup>

Vizitat e gjyqtarëve nuk janë mbajtur çdo gjashtë muaj siç e parasheh KDM, duke nënkuptuar shkelje të dispozitave të KDM. Të miturit dhe stafi i qendrës janë shumë të pakënaqur me bashkëpunimin me gjykatat sa i përket vizitave të gjyqtarëve për të mitur. Një nga të miturit thekson që “jam tash e 1 vit e gjysmë dhe as një vizitë nuk ka pasur nga ana e gjyqtarit”.<sup>24</sup> Gjithashtu stafi i intervistuar nga KOMF deklarojnë se vizitat nuk realizohen siç është e paraparë me KDM.<sup>25</sup>

Gjatë periudhës monitoruese gjashtë mujore janë realizuar vetëm 3 vizita.

- Rekomandohet realizimi i vizitave nga gjyqtarët tek të miturit çdo gjashtë (6) muaj, për të përcjellë trajtimin e të miturve dhe për të vlerësuar nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme.
- Rekomandohet që në kuadër të plotësim ndryshimit të KDM, të parashihet që në rast të çfarëdo të mete apo vërejtjeje, gjyqtari kompetent për të mitur, krahas institucioneve të lartpërmendura, duhet të informojë Inspektoriatin në kuadër të MD.

22 Neni 127, Kodi i Drejtësisë për të Mitur

23 Neni 127, Kodi i Drejtësisë për të Mitur

24 Intervistë me të miturin NN në QKL

25 Intervistë me drejtorin e QKL dhe zyrtarin korrektues



## Mungesa e programeve të standardizuara individuale për të miturit

Sipas KDM, programi individual duhet përgatitur në bazë të analizave gjithëpërfshirëse të karakteristikave të veçanta të të miturit, shkaqeve dhe llojit të veprës penale, sjelljes, shkallës së arsimimit, zhvillimit të të miturit dhe rrethanave të jetës së tij familjare.<sup>26</sup>

Programi individual që është dokumenti kyç në përcaktimin e ndërhyrjeve tek i mituri dhe monitorimin e tyre, mungon. Programi individual duhet të dizajnohet për secilin të mitur në bazë të anamnezës së tij/saj fillestare i cili veç historisë, anëve të forta dhe anëve të dobëta të të miturit, përmban edhe planin individual të veprimit me hapat që janë parashikuar të ndiqen, ndërhyrjet që planifikohen në punën me të, afatet kohore dhe monitorimin e zbatimit të tij. Ai duhet të hartohet nga ekipi multidisiplinar përfshirë punëtorin social, psikologun, shërbimin sprovues, të miturin, familjen dhe profesionistët e tjerë sipas nevojës.

Programi aktual që shërben si dokument që vendos fundamentet e procesit në të cilin kalon i mituri gjatë qëndrimit nën masën e shqiptuar për qëndrim në QKL, quhet program i reintegrimit. Dokumenti me të cilin punon punëtori social, është vetëm një pjesë e caktuar e një plani të standartizuar individual. Ky program nuk është një program i standartizuar individual pasi nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk trajton të gjitha hallkat nëpër të cilat një i mitur duhet të kalojë, siç janë: vlerësimi, mbrojtja, rehabilitimi, edukimi, aftësimi profesional dhe reintegrimi.

Në periudhën e monitorimit, për asnjë nga 48 të miturit në QKL nuk janë hartuar programet individuale. Mos hartimi i programeve individuale të fëmijëve përbën shkelje të nenit 85 të KDM dhe rrjedhimisht rezulton me pasoja në mbrojtjen, rehabilitimin, edukimin dhe reintegrimin e të miturve në QKL.<sup>27</sup> Në bazë të intervistës së realizuar me punëtorin social të QKL dhe shqyrtimit të dosjeve të të miturve, është konstatuar se programet individuale nuk përgatiten dhe shpeshherë ka paqartësi në të kuptuarit e programit individual duke e nënkuptuar programin e reintegrimit si program individual.<sup>28</sup> Po ashtu, edhe programi për reintegrim për të mitur mungon për të miturit nga Komuna e Gjilanit si pasojë e ndryshimit të zyrës së Shërbimit Sprovues në këtë zyrë rajonale.<sup>29</sup> Megjithatë, në takimet me përfaqësuesit e shërbimit sprovues nga zyra e Gjilanit, ata bëjnë me dije se kjo nuk mund të jetë arsye, sepse shërbimi sprovues është vendosur në zyrat e reja prej më shumë se një viti.

Në hartimin e programit individual nuk merr pjesë psikologu si një nga hallkat e rëndësishme të vlerësimit të gjendjes së të miturit në aspektin emocional dhe psikik. Nga muaji qershor janë dhënë zotimet që do të përfshihet dhe psikologu në ekipin hartues të këtij plani. Gjatë tërë procesit prindërit paraqiten si hallkë problematike duke shfaqur tendencë të kritikës dhe gjykimit ndaj fëmijës për veprën e kryer por pa qenë në dijeni për efektin negativ në procesin e risocializimit dhe reintegrimit të të miturve kryerës të veprave penale.<sup>30</sup> Këtu duhet të intervenohet me gjetjen e alternativave për t'i përfshirë prindërit në proces më shumë, duke njohur e pranuar rëndësinë e tyre.

26 Neni 85 Neni 37, Kodi i Drejtësisë për të Miturit

27 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 85; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>.

28 "PLANI I MENAXHIMIT TË RASTIT DHE PROGRAMI I PËRKUJDESJES SË PAS LIRIMIT", STANDARDET DHE PROCE-DURAT"

29 Intervistë me Punëtorin Social në QKL

30 Intervistë me Punëtorin Social në QKL

Mungesa e një programi individual të standarizuar bën që mos të ketë një koordinim të veprimeve dhe punës me të miturit nga secili profesionist dhe bën që aktivitetet me ta, të jenë të pastrukturuara dhe kaotike duke zbehur ndjeshëm suksesin dhe efikasitetin e ndërhyrjeve të miturit. Në të njëjtën kohë konstatohet mungesa e takimeve të rregullta të ekipit multidisiplinar që punon me të miturit, për të diskutuar rastet specifike dhe vendosur për hapat e ardhshëm. Komunikimi mes tyre është më shumë sporadik dhe i pakoordinuar që krijon vështirësi në rehabilitim e reintegrimin përfundimtar të të miturve në shoqëri.

Stafi profesional që është jashtëzakonisht i domosdoshëm, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e programeve mbetet i pamjaftueshëm për shkak të mangësive buxhetore. QKL ka vetëm një psikologe në kuadër të shërbimit shëndetësor dhe aktualisht 2 punëtor social të cilët nuk arrijnë të përballojnë numrin e madh të personave në QKL.

- Duke konsideruar faktin se moshë 14 – 18 vjeçare karakterizohet me ndryshime të mëdha e mjaft domethënëse si në aspektin fizik ashtu dhe atë psikik, rekomandohet fuqishëm hartimi i formateve të programeve individuale të standartizuara nga MD për stafin profesionist që punon me të miturit në QKL.

## Programet për rehabilitim dhe reintegrim

Gjatë procesit të monitorimit dhe vizitave të zhvilluara në QKL, i është kushtuar një vëmendje e veçantë programeve ekzistuese për rehabilitim dhe reintegrim. Kjo për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme në rehabilitim dhe reintegrim të të miturve në shoqëri dhe reduktim të recedivizmit tek të miturit. Programe të kësaj natyre në QKL, mungojnë në një masë të ndjeshme.

Aktualisht dy programe që janë duke vijuar në QKL me të miturit, janë Terapia e Grupit dhe Programi për Menaxhimin e Zemërimit EQUIPE i cili zhvillohet në kuadër të një projekti Hollandez dhe që është thuajse në përfundim të tij. Për këto programe e sidomos për EQUIPE, interesimi i të miturve është jashtëzakonisht i madh. Ata janë shumë të rregullt në ndjekjen e tij dhe e presin me padurim ditën e përcaktuar për programin. Këtë program e kanë ndjekur 12 të mitur.

Kombinimi i këtyre dy programeve ka rezultuar mjaft i suksesshëm dhe është realisht duke i rehabilituar të miturit dhe aftësuar ata për të kontrolluar dhe menaxhuar ndjenjat e tyre në një mënyrë të shëndetshme. Programi EQUIPE është në fazë përfundimtare, prandaj rekomandohet që të gjinden zgjidhje alternative për të garantuar qëndrueshmërinë e tij edhe pas përfundimit të projektit. Ky program është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i nevojshëm për këta të mitur dhe vazhdimi i tij në të ardhmen është një domosdoshmëri në QKL.

Megjithatë, këto dy programe janë shumë pak për të përmbushur funksionet që një qendër edukuese / korrektuese duhet të ketë dhe programet që ajo duhet të aplikojë me të mitur, sidomos ata nën masa edukative institucionale. Shtimi i programeve edukative për rehabilitim dhe reintegrim të të miturve, do të ndikonte ndjeshëm që ata të mos kryenin sërish shkelje pas daljes nga QKL, duke reduktuar kështu dukurinë e recedivizmit dhe duke dëshmuar në këtë mënyrë sukses të shërbimit korrektues në tërësi.

Një mangësi tjetër e evidentuar në sferën e rehabilitimit dhe reintegrimit të këtyre të miturve është mungesa e punës me familjen. Edhe pse programi për menaxhim të rastit dhe reintegrim parasheh edhe përfshirjen e familjes, kjo nuk ndodh, puna me familjen mungon thuajse tërësisht. Punëtori social shprehet se shumë rrallë organizohen takime me të gjithë prindërit së bashku ku diskutohet për çështje të ndryshme. Për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme, është i pamundur udhëtimi në gjithë territorin e Kosovës për të patur takime më të shpeshta me prindërit dhe për të punuar më shumë me ta. Në anën tjetër kryesisht këto familje kanë të ardhura ekonomike relativisht të ulëta dhe kanë vështirësi madje edhe për të ardhur në QKL, për të vizituar fëmijët e tyre.<sup>31</sup>

- Rekomandohet shtimi i programeve edukative për rehabilitim dhe reintegrim të të miturve, duke reduktuar kështu dukurinë e recedivizmit dhe duke dëshmuar në këtë mënyrë sukses të shërbimit korrektues në tërësi.
- Rekomandohet që të gjinden zgjidhje alternative për të garantuar qëndrueshmërinë e programeve rehabilituese edhe pas përfundimit të projekteve të mbështetura nga OJQ-të.
- Rekomandohet që QKL të ketë një buxhet për të mbuluar transportin e familjeve me vështirësi financiare, në mënyrë që prindërit të përfshihen në procesin e rehabilitimit dhe reintegrimit të të miturve.

## Procesi arsimor për të miturit në Qendrën Korrektuese

Neni 119 i KDM përcakton se nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativ korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.<sup>32</sup>

Gjatë periudhës monitoruese janë konstatuar vështirësi të shumta në mbarëvajtjen e sistemit arsimor, si në aspektin e organizimit të procesit arsimor ashtu edhe në atë të cilësisë së mësimdhënies, mungesës së orëve të rëndësishme mësimore duke rezultuar në nivel arsimor shumë të dobët. Bazuar në konstatimin se aktualisht procesi mësimor që zhvillohet brenda QKL, është i një niveli shumë të dobët dhe në pajtim me dispozitat e KDM, rekomandohet fuqishëm krijimi i kushteve që këta të mitur të vijojnë mësimin në shkolla të rregullta publike jashtë institucionit edukativ korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative. Ky konstatim bazohet në të gjeturat e mëposhtme.

Numri i vogël i mësimdhënësve të angazhuar në QKL, mos-mbajtja e të gjitha lëndëve mësimore si dhe bashkimet e klasave, mbeten ndër sfidat kryesore të mësimdhënësve të cilat çenojnë rëndë mbarëvajtjen dhe cilësinë e procesit mësimor, përfshirë mësimdhënien dhe mësimnxënien. Përkatësisht bashkimet janë bërë si vijon: klasa e 7 dhe klasa e 9 bashkë, klasa e 6 dhe klasa e 8 bashkë si dhe klasa e 10, 11 dhe 12 bashkë. Ora e mësimit e cila zgjat 30 minuta, i dedikohet herë njëjës klasë e herë klasës tjetër. P.sh. me të miturit që ndjekin klasën e 6 dhe të 8 të cilët e zhvillojnë mësimin bashkë në klasë mikse, arsimtari zhvillon një orë mësimore për klasën e 6 dhe orën e ardhshme për klasën e 8. Kjo sjell mungesë të interesit të të miturve të tjerë që ndihen të papërfshirë, mungesë të përqendrimit e

31 Intervista me punëtorin social

32 Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 119; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2698>.

vëmendjes gjë që rezulton me cënim të mbarëvajtjes së orës mësimore në tërësi. Mesatarisht janë rreth 15-16 të mitur që vijojnë arsimin 9-vjeçar (klasa e 6, 7, 8 dhe 9) dhe rreth 30 të mitur që vijojnë arsimin e mesëm (klasa e 10, 11 dhe 12). Mësimi zhvillohet ndaras për djemtë dhe për vajzat.<sup>33</sup>

Drejtimi i vetëm Elektroteknikë – Profili Informatikë, i ofruar për të miturit që e kanë përfunduar arsimin 9 vjeçar, përbën një mangësi në sistemin arsimor brenda QKL, duke cënuar kështu të drejtën e nxënësve për të zgjedhur drejtimin që është më i përshtatshëm për ta. Kjo pasi të miturit vijnë nga shkolla me drejtime të ndryshme, ndjekin pjesërisht Elektroteknikën brenda QKL dhe pasi e lëshojnë qendrën hasin në vështirësi të shumta për tu rikthyer e ripranuar në drejtimet e mëparshme për shkak të specifikave të drejtimit të elektroteknikës dhe lëndëve të ndjekura të cilat nuk përputhen me ato të drejtimeve të tjera.

Në anën tjetër ky drejtim paraqet një ndër drejtimet më të vështira të ciklit të arsimit të mesëm të lartë, gjë e cila e shton edhe më shumë vështirësinë për ofrimin e një procesi mësimor cilësor dhe zhvillimin e të nxënësve nga ana e të miturve që ndjekin shkollimin në QKL. Programi mësimor ka shumë ngarkesë, ka një numër të madh lëndësh<sup>34</sup> dhe nuk merr në konsideratë kushtet, nivelin dhe situatën e të miturve në ambientet e QKL.

Gjatë semestrit të parë nuk janë mbajtur të gjitha lëndët mësimore të parapara në kurrikulat përkatëse për shkak të numrit të vogël të mësimdhënësve, por kjo gjë sipas tyre është rregulluar gjatë semestrit të dytë pasi të dy shkollat publike nga komuna e Lipjanit për dhënien e dëftesave në përfundim të vitit akademik, kanë vendosur si kriter strikt ndjekjen e të gjitha lëndëve të paracaktuara në kurrikula. Megjithatë, mbulueshmëria e lëndëve është bërë mes mësuesve ekzistues ku ata tashmë veç lëndës në të cilën janë diplomuar, japin edhe lëndë të tjera “të përafërta” por për të cilat nuk zotërojnë diplomë.

Procesi mësimor mbahet brenda QKL por ekipi i arsimtarëve funksionon nën varësinë dhe mbikëqyrjen e shkollave si dhe departamenteve përkatës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Mësimdhënësit vijnë në QKL nga dy shkolla të komunës së Lipjanit, përkatësisht shkolla 9-vjeçare “Ismail Luma” dhe ajo e mesme “Adem Gllavica” e cila aplikon një kurrikulë të re në drejtimin Elektroteknikë – Profili Informatikë. Numri total i mësimdhënësve brenda QKL është 8 arsimtar, numër i cili nga vetë ata konsiderohet i vogël për të ofruar një proces arsimit cilësor.<sup>35</sup>

Problematikë tjetër e identifikuar nga KOMF është gjithashtu mungesa e teksteve mësimore. Pavarësisht kërkesave për furnizim, herë pas here ka vështirësi me furnizimet me tekstet mësimore me ç’rast, jo rrallëherë tekstet mungojnë duke ndikuar negativisht në të gjithë procesin mësimor të të miturve dhe duke zbehur cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies. Për disa nga lëndët, tekstet mësimore nuk ekzistojnë fare.<sup>36</sup>

33 Intervista me mësimdhënësit në QKL

34 Lëndët mësimore të cilat trajtohen në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) dhe atë të mesëm të lartë (klasat 10-12) janë: Cikli i mesëm i ulët: Gjuhë shqipe; Gjuhë angleze; Matematikë; Fizikë; Kimi ; Biologji; Histori; Gjeografi; Njeriu dhe Natyra; Edukatë Edukatë muzikore; Edukatë figurative; Edukatë qytetare; Edukim Shëndetësor; Edukatë fizike; Cikli i mesëm i lartë, klasa e 10: Gjuhë shqipe; Gjuhë angleze; Matematikë; Kimi ; Biologji; Edukatë qytetare; Histori; Edukatë fizike dhe sportive; Edukatë shëndetësore; Multimedia; Interneti; Mbrojtja dhe siguria në punë; Materialet elektronike; Teknologji informative; Ekonomi dhe ndërmarrësi; Bazat e elektronikës; Vizatim teknik dhe dokumentacion; Bazat e telekomunikacionit; Modulet e praktikës profesionale. Ndërkohë që në klasën e 11 dhe të 12 lëndët që i shtohen kurrikulës së klasës së 10 janë Fizikë, Gjeografi dhe Matje elektrike, kurse lëndët që eliminohen nga kurrikula e klasës së 10 janë Biologji, Kimi, Multimedia dhe Interneti.

35 Intervista me mësimdhënësit në QKL

36 Intervista me mësimdhënësit në QKL

Mungesa e trajnimeve të nevojshme për punën dhe trajtimin e kësaj kategorie të veçantë të të miturve është një tjetër e gjetur e konsideruar si një sfidë që i shoqëron mësimdhënësit. Trajnimet e tilla konsiderohen si mjaft të nevojshme për një punë efektive me të miturit.

Në përgjithësi në bisedat e të miturve ndihet mungesa e interesit për ndjekjen e procesit mësimor në QKL. Disa prej tyre shkojnë në klasë për të respektuar rutinën ditore dhe për të kaluar një pjesë të ditës. Tek të miturit vihen re dukshëm pakënaqësitë që kanë në lidhje me mësimin ku përmendin mungesën e kushteve cilësore dhe miksimin e klasave që sipas tyre shkakton rrëmujë dhe dëmton orën e mësimin.<sup>37</sup>

- Duke pasur parasysh faktin se sipas KDM, QKL është institucion gjysëm i hapur, duke pasur parasysh se masa edukative ekzekutohet duke respektuar personalitetin dhe dinjitetin e të miturve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre fizik, moral dhe intelektual, duke marrë parasysh vështirësitë e identifikuar gjatë monitorimit të procesit arsimor të QKL, si dhe duke marrë parasysh interesin më të mirë të të miturve dhe të drejtën e tyre themelore për arsim cilësor, rekomandohet fuqishëm ndërmarrja e të gjitha masave për krijimin e kushteve të nevojshme në mënyrë që sa më shpejtë të miturit të fillojnë ndjekjen e arsimit në shkolla publike jashtë QKL.

## Kalueshmëria e të miturve në sistemin arsimor në QKL

Mësimdhënësit deklarojnë se përgjithësisht kalueshmëria e nxënësve në QKL është 100% pasi edhe vetë qasja e tyre si arsimtarë synon që ti motivojë më tej të miturit duke mos i lënë që të përsërisin vitin. Ata tregojnë se ky vit akademik do të përfundojë në Gusht 2016, për shkak të vonesave në nisjen e procesit mësimor në QKL, ku konkretisht ai ka filluar në datën 7 Dhjetor 2015, pra rreth tre muaj me vonesë.

## Mungesa e edukatorëve dhe e programeve edukative

Sipas KDM, të miturit ndahen në grupe edukative në harmoni me moshën e tyre, zhvillimin mendor dhe karakteristikat e tjera në pajtim me veçoritë e programit të individualizuar. Grupi edukativ ka më së shumti njëzet (20) të mitur dhe një (1) edukator të veçantë.<sup>38</sup>

Edhe pse e paraparë me KDM, në periudhën monitoruese është konstatuar mungesë totale e edukatorëve dhe mungesë e programeve edukative të nevojshme që evidentohet si një mangësi domethënëse në ambientet e QKL e cila reflektohet në të gjitha sferat e trajtimit të të miturve për të arritur rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre.

Edukatori duhet të jetë pjesë e stafit profesional i cili punon në vazhdimësi me të miturit, gjë të cilën për momentin duket se e kryen në një mënyrë oficeri korrektues edhe pse ky i fundit nuk është pjesë e stafit profesional dhe nuk mund të punojë në edukimin e të miturve. Prania e edukatorëve do të plotësonte programet rehabilituese e integruese për të miturit dhe do të forconte komunikimin / koordinimin multidisiplinar me profesionistët e tjerë si punëtori social, psikologu, psikiatri, etj.

<sup>37</sup> Intervista me të miturit

<sup>38</sup> Neni 117, Kodi i Drejtësisë për të Mitur

- Grupi edukativ prej 20 të miturve dhe një edukatori të veçantë i paraparë në KDM, mbetet një numër i madh i përfituesve që për pasojë zbeh suksesin e punës së edukatorit me secilin prej 20 të miturve. Rekomandohet që në plotësim ndryshimin e KDM, të parashihet grupi edukativ prej më së shumti 10 të mitur në raport me një edukator.

## Kujdesi shëndetësor për të miturit në qendrën edukative korrektuese

Shërbimi i kujdesit shëndetësor në burgjet e Republikës së Kosovës organizohet dhe funksionon si pjesë integrale e sistemit shëndetësor të vendit. Shërbimi funksionon në burgjet të cilat janë nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, por për shkak të specifikave organizohet dhe mbikëqyret nga departamenti përkatës në Ministrinë e Shëndetësisë. Deri në fund të vitit 2015, sistemi shëndetësor në QKL ka qenë nën menaxhimin e drejtorit të QKL, përkatësisht nën autoritetin e MD. Nga janari 2016, stafi shëndetësor ka kaluar nën menaxhimin e MSH.

Në Qendrën Edukative Korrektuese funksionon Ambulanca e përbërë nga stafi përkatës mjekësor dhe një psikologe e cila gjithashtu funksionon në kuadër të shërbimit shëndetësor të ofruar në QKL. Ambulanca ka funksionin e ofrimit të kujdesit shëndetësor për të miturit me masë edukative korrektuese, të miturit e dënuar në qendrën korrektuese, femrat e dënuara dhe personat e vendosur në paraburgim.

## Organizimi i stafit shëndetësor

Aktualisht, në ambulancën për ofrim të shërbimeve shëndetësore janë;

- Katër (4) mjekë bashkë me mjekun përgjegjës (punojnë me ndërrime);
- Gjashtë (6) teknikë dhe motra kryesore (punojnë me ndërrime);

Përderisa, specialistët të cilët vijnë gjatë javës sipas nevojës janë: psikiatri dhe gjinekologu.

Të gjithë mjekët janë të specializuar në drejtime të ndryshme, por të gjithë janë të punësuar me kontratë si mjekë të përgjithshëm. Stafi shëndetësor është nën menaxhimin direkt të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht nën menaxhimin e Departamentit për Shërbimin Shëndetësor në Burgje, i cili funksionon në kuadër të MSH.

Gjatë periudhës monitoruese, personat e intervistuar kanë dhënë këndvështrime të ndryshme sa i përket efikasitetit të kësaj forme të organizimit. Sipas stafit shëndetësor përfshirë psikologin, ky organizim është më efikas sepse ka krijuar pavarësi në funksionim.<sup>39</sup> Përderisa, drejtori i QKL konsideron se ky organizim ka sjellë vështirësi në ofrimin e shërbimit shëndetësor, duke përfshirë edhe vonesa në vendosjen e kontaktit mes stafit shëndetësor dhe të miturve.<sup>40</sup>

- Duke qenë se kjo është një formë e re e organizimit dhe rreth saj ekzistojnë këndvështrime të ndryshme, rekomandohet që të bëhet një vlerësim për nivelin e knaqshmërisë së të miturve në marrjen e shërbimit shëndetësor gjatë vitit 2015 dhe gjashtë muorit të parë të vitit 2016. Ky vlerësim do të siguronte informacionin e nevojshëm për të përcaktuar ndërhyrjet për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e cilësisë.

39 Intervistë me mjekun përgjegjës kryesore

40 Intervistë me drejtorin e QKL

## Këkesat e të miturve për shërbime shëndetësore

Gjatë periudhës monitoruese janar – qershor 2016, në bazë të regjistrave, numri i kërkesave të të miturve për kujdes shëndetësor është shumë i madh. Mjekja përgjegjëse e intervistuar thekson që mesatarja e kërkesave në ambulancë brenda një muaji sillet rreth 300 kërkesa, ku prej tyre rreth 80 kërkesa janë nga të miturit.<sup>41</sup>

Shqetësimet kryesore të të miturve janë: gripet / virozat, lëndimet në sport, rrahjet / lëndimet mes të miturve, vetë lëndimet, problemet me stomak, problemet me urinim, problemet me gjumë (insomnia), stresi, ankthi etj. Bazuar në monitorimin e KOMF, të miturit të cilët janë në parburgim, vijnë kryesisht me simptoma të stresit dhe ankthit. Këto simptoma kryesisht i shfaqin më shumë para seancave gjyqësore. Stresi dhe ankthi pastaj manifestohen edhe me simptoma fizike.

Sipas stafit shëndetësor jo të gjitha kërkesat e të miturve janë me arsye. Ka shumë raste kur të miturit stimulojnë simptoma të sëmundjeve të ndryshme për të ardhur në ambulancë si një pretext për të lëvizur në ambientet e QKL: “Kemi pasur një rast kur i mituri ka simuluar simptomat e epilepsisë duke humbur vetëdijen dhe duke shtrënguar muskujt. Pas një egzaminimi të hollësishëm, kemi ardhur në përfundim që i mituri ka simuluar simptomat”.<sup>42</sup>

Të shpeshta janë edhe kërkesat e të miturve për të dalë jashtë QKL për trajtim shëndetësor. Të miturit dërgohen në trajtim jashtë qendrës vetëm për shërbimet / trajtimet të cilat nuk mund të ofrohen brenda QKL. Rastet e tilla janë të rralla, ku mesatarja sillet rreth pesë (5) raste të të miturve në muaj. Të miturit të cilët kanë nevojë për trajtim shëndetësor jashtë qendrës korrektuese dërgohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK. Për të lehtësuar këtë çështje, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes të MSH dhe QKUK, ku bazuar në këtë marrëveshje është dërguar për informim edhe qarkorja tek të gjitha spitalet në Kosovë. Kjo qarkore ka lehtësuar punën ku rastet e të miturve në QKUK merren me prioritet të lartë edhe duke pasur parasysh që të miturit dërgohen nga një institucion korrektues.

Mungesa e një autoambulance për rastet emergjente të të miturve paraqet vështirësi, atëherë kur ato duhet të transportohen në institucione shëndetësore më të specializuara. Edhe pse për fat raste të tilla nuk kanë qenë të shpeshta, kur është nevojitur transport imediat të miturit janë transportuar me automjetet e zakonshme që disponon QKL të cilat sigurisht nuk i plotësojnë kriteret për transportin e pacientëve me probleme shëndetësore. Autoambulanca ndodhet në burgun e Dubravës por ajo mund të kërkohet vetëm paraprakisht pasi në rastet urgjente nuk ka kohë të mjaftueshme në dispozicion për të pritur ardhjen e saj deri në QKL.<sup>43</sup>

41 Intervistë me mjeken përgjegjëse në QKL

42 Ibid.

43 Intervista me drejtorin e QKL

## Lista esenciale e barnave

Stafi shëndetësor deklaron se qëndron mirë me listën esenciale të barnave “Ne qëndrojmë mirë me listën esenciale të barnave, qëndrojmë shumë më mirë se sa QKUK”, edhe pse nuk mohojnë që në momente të caktuara mund të ketë mungesë të ndonjë bari nga lista esenciale e barnave.<sup>44</sup>

- Rekomandohet furnizimi i rregullt me të gjitha barnat nga lista esenciale e barnave, aq më shumë duke pasur parasysh ndjeshmërinë e rasteve. QKL nuk duhet të ketë mungesë të barnave nga lista esenciale dhe duhet të jetë gjatë gjithë kohës e furnizuar me to.

## Niveli i kënaqshmërisë së të miturve me shërbimet shëndetësore dhe psikologjike

Nga bisedat e zhvilluara me të miturit rreth shërbimeve shëndetësore të ofruara në QKL, rezulton se shërbimet shëndetësore dhe trajtimi nuk janë gjithmonë në nivelin e duhur. Zakonisht mjekët vonohen në ofrimin e shërbimit prej kohës kur i mituri e kërkon ndihmën mjekësore.<sup>45</sup>

Ka raste kur të miturit pas marrjes së shërbimit shëndetësor apo pas trajtimit vijnë falenderohen dhe shprehen se janë të kënaqur. Ka raste kur të miturit kanë ankesa sa i përket trajtimit shëndetësor dhe nuk janë ndarë të kënaqur.

Ndërkohë për cilësinë e shërbimit psikologjik të miturit janë të dyzuar. Disa prej tyre gjatë intervistës kanë rrëfyer se kanë shkuar te psikologia, kanë marrë shërbime e kanë biseduar me të dhe se janë pergjithësisht të kënaqur nga ky shërbim. Të tjerë të mitur kanë reflektuar një mungesë besimi ndaj psikologes duke u shprehur se brengat dhe shqetësimet e tyre janë vënë në dyshim nga psikologia duke bërë në këtë mënyrë që të humbasë tërësisht besimi dhe të mos ndërtohet marrëdhënia e shëndetshme terapeutike që determinon edhe suksesin e vetë terapisë.<sup>46</sup> Në këtë aspekt, rekomandohet që psikologia të fokusohet dhe të investojë në ndërtimin e raportit të besimit me të miturit.

- Rekomandohet realizimi i vlerësimeve periodike për nivelin e kënaqshmërisë së të miturve lidhur me cilësinë e shërbimit shëndetësor dhe psikologjik, të gjeturat e të cilit shërbejnë për të përcaktuar hapat dhe ndërhyrjet e nevojshme për përmirësimin e këtyre shërbimeve.

44 Ibid.

45 Intervistat me të miturit në QKL

46 Intervistat me të miturit në QKL



## Nevoja për ngritje të kapaciteteve

Stafi shëndetësor nuk ka pasur trajnime për ngritje të kapaciteteve për punën me të mitur. Pas kalimit të stafit shëndetësor nën menaxhimin e MSH, teknikët kanë marrë pjesë në një trajnim të organizuar nga MSH për trajnimin e vazhdueshëm profesional.

Stafi shëndetësor ka marrë pjesë edhe në një trajnim tjetër të organizuar nga QKL për punën me të mitur, po që sipas tyre nuk ka qenë i dobishëm për stafin shëndetësor, meqenëse trajnimi ka qenë i orientuar për stafin korrektues dhe jo për nevojat e stafit shëndetësor.<sup>47</sup>

Stafi shëndetësor është i trajnuar për programin me metadon, mirëpo fatmirësisht për momentin nuk ka të mitur në QKL që kanë nevojë për këtë program.<sup>48</sup>

- Rekomandohet ngritja e mëtejshme profesionale e stafit shëndetësor përmes trajnimeve të specializuara për punën me të miturit në qendra korrektuese edukative.

## Shërbimi psikologjik në QKL

Brenda ambienteve të ambulancës ofron shërbimin e saj edhe një psikologe e cila kryen vlerësime psikologjike dhe teste diagnostike, ofron këshillim psikologjik si dhe terapi grupi. Intervistimi që bëhet me të miturin brenda tre ditëve të para të pranimit të tij në QKL e që i shërben përpilimit të anamnezës fillestare, si edhe testet e përdorura nga psikologjia gjatë trajtimit të të miturit, janë dokumente të standartizuara dhe të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë. Aktualisht psikologjia ka nën trajtim rreth 40 të mitur. Ajo shton se si pjesë e pjesshme e stafit, veprojnë edhe psikiatri dhe gjinekologu të cilët angazhohen sipas nevojës në QKL.

- Rekomandohet rritja e numrit të psikologëve në QKL ku bazuar në standartet e reja, një psikolog duhet të punojë me 7 deri në 10 të mitur.
- Rekomandohen trajnime të vazhdueshme dhe mjaft specifike të ndërlidhura me ofrimin e këshillimit dhe psikoterapisë, terapisë së grupit dhe terapisë familjare si dhe mundësimi i seancave të vazhdueshme të supervizimit për të shmangur “shterimin/djegien profesionale” (burnout).

47 Intervista me stafin shëndetësor

48 Intervista me stafin shëndetësor

## Referimi i rasteve për trajtim

Përveç rasteve që psikologjia trajton nga vizitat e zhvilluara nëpër pavione dhe bisedat me të mitur, referimet e tjera për trajtime më specifike të rasteve ajo i merr nga tekniku dhe infermieri të cilët në mënyrë konstante mbajnë shënime për të miturit dhe në vazhdimësi i referojnë ato te psikologjia. Oficerët korrektues janë poashtu persona që referojnë raste për trajtim te psikologjia. Konstatohet mungesë bashkëpunimi në mes të psikologes dhe punëtorit social qoftë në referim të rasteve apo edhe gjatë trajtimit të tyre.

### Sfidat në shërbimin psikologjik

Numri i madh i të miturve që përfitojnë nga shërbimi psikologjik, duke shtuar dhe numrin e femrave të dënuara dhe personave të tjerë në paraburgim e çënojnë ndjeshëm cilësinë e ofrimit të shërbimit psikologjik për shkak se koha dhe puna individuale e dedikuar secilit person reduktohet dukshëm. Aktualisht, një psikologe angazhohet për rreth 90 rezident në QKL. Sfidë tjetër e shërbimit psikologjik është edhe mungesa e planit individual për secilin të mitur, mungesa e takimeve të ekipit multidisiplinar për të diskutuar mbi rastet dhe mungesa e takimeve me familjen e cila mbetet një shtyllë themelore për reintegrimin e qëndrueshëm të të miturit në shoqëri.<sup>49</sup>

Psikologjia përgatit raporte të rregullta dhe ad hoc, të cilat i dorëzon te zëvendës drejtoresha e QKL. Në përgjithësi, të miturit që gjenden në QKL nuk kanë paraqitur te psikologjia ndonjë ankesë. Shumë rrallë ka patur shqetësime apo ankesa të ngritura nga të miturit për ushtrim të dhunës nga ana e stafit. Të gjitha ankesat dhe shqetësimet që të miturit mund të ngrenë për çështje të ndryshme, psikologjia i referon me shkrim apo gojarisht tek zëvendës drejtoresha e QKL.<sup>50</sup>

### Aftësimi profesional

Sipas KDM, gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathtësitë, interesimet dhe punën që janë duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues.

### **Brenda ambienteve të QKL ekziston edhe Qendra e Aftësimit Profesional e cila ofron këto kurse:**

- Hidroinstalues
- Elektroinstalues
- Ndërtimtari

### **Për të ofruar më shumë mundësi zgjedhjeje, për të miturit ofrohen edhe kurset:**

- Informatikë
- Floktari dhe
- Rrobaqepësi

49 Intervista me psikologjen e QKL

50 Intervista me psikologjen e QKL

Diplomat që u jepen të miturve të cilët i përfundojnë këto kurse, lëshohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Punës dhe e Mirëqënies Sociale dhe ato janë tërësisht të barazvlefshme me diplomat e ngjashme që lëshohen jashtë ambienteve të QKL. Në diplomë nuk shkruhet vendi se ku i mituri e ka ndjekur kursin, duke shmangur kështu stigmatizimin apo diskriminimin potencial të të miturit në të ardhmen. Trajnimet profesionale gjatë kësaj periudhe i kanë ndjekur 10 të mitur.<sup>51</sup>

Megjithatë vihet re nevoja për të shtuar kurse të tjera që janë atraktive për të miturit, që nxisin zhvillimin e aftësive dhe kreativitetin tek të miturit dhe ndihmojnë në rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre. Kurse të tilla mund të jenë të karakterit artistik si për shembull kurse për pikturë, për aktrim apo ato të karakterit sportiv. Një gjë e tillë deri tani nuk është bërë e mundur për shkak të mungesës së fondeve për të siguruar trajnerë apo profesorë nga jashtë. Një tjetër kurs që mungon e për të cilin ka edhe kërkesa nga të miturit, është kursi i automekanikës i cili shihet edhe si një mundësi e mirë nga të miturit për të patur më shumë mundësi qasjeje në tregun e punës dhe për të siguruar të ardhura, pas daljes nga QKL.

Kjo gjë dëshmohet edhe nga biseda me të miturit në QKL të cilët shprehen se do të ishin të interesuar për të ndjekur kursin e automekanikës. Gjithashtu gjatë bisedave me ta në lidhje me kurset e aftësimit profesional vihet re interesimi i tyre për tu angazhuar në kurse dhe për tu aftësuar në zanate të ndryshme të cilat do të ishin një mundësi më shumë për tu punësuar pas daljes nga QKL.<sup>52</sup>

## Aktivitetet e lira ekstrakurrikulare dhe sportive

I mituri ka të drejtë që të ushtrojë në mënyrë të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe të kalojë së paku tri (3) orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Të miturit i garantohet një ambient i sigurt për t'u marrë me sport, për të ushtruar dhe për aktivitete të tjera fizike.<sup>53</sup>

Aktivitetet sportive / rekreative ofrohen në baza ditore për të miturit që ndodhen në QKL. Një orë gjatë ditës dedikohet për aktivitetet sportive si ato në sallën e sportit apo në palestër. Gjithashtu në fundjavë organizohen lojra të ndryshme apo edhe aktivitete mes të miturve.

Të miturit i ndjekin aktivitetet e tilla dhe i preferojnë shumë ato. Ata dëshirojnë që të ofrohen me shumë aktivitete me karakter sportiv pasi janë tejet atraktive dhe tërheqës për ta. Të miturit i konsiderojnë të pamjaftueshme lojrat sportive që ofrohen aktualisht.

51 Intervista me drejtorin e QKL

52 Intervistat me të miturit në QKL

53 Neni 118 Kodi i Drejtësisë për të Miturit

## Biblioteka

QKL është e paisur me një bibliotekë e cila është nën menaxhimin e QKL. Personi përgjegjës për punën në bibliotekë është Koordinatori i programeve në QKL.

Biblioteka është e hapur çdo ditë nga e Hëna deri të Premten, prej orës 08:00 – 16:00. Të gjitha pavionet kanë të drejtën që një herë gjatë javës të vizitojnë bibliotekën për të marrë apo shkëmbyer ndonjë libër.

Biblioteka është e pajisur në total me rreth 3,500 ekzemplarë të librave. Librat janë të ndarë në seksionet si vijon: Poezi; Romane; Letërsi për fëmijë; Islamizmi; Psikologji; Monografi; Filozofi; Ekonomi; Filozofi e moralit; Historia e popullit dhe Muzikë. Librat janë në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe gjermane.

Furnizimi i fundit me libra është bërë rreth një vit e gjysëm më parë dhe ka nevojë për botime të reja për të përmbushur kërkesat e të miturve. Aktualisht nuk ekzistojnë fonde të veçanta të dedikuara për të pasuruar bibliotekën me tituj të rinj.

Sipas monitorimit të KOMF, bazuar edhe në intervistat me përgjegjësit relevant, të miturit kryesisht janë më shumë të interesuar të lexojnë libra rreth psikologjisë. Ka kërkesa nga të miturit edhe për botimet e reja, por të cilat nuk gjenden në bibliotekën në QKL. Familjarët ju sjellin të miturve libra nga jashtë, ku shumë prej të miturve vendosin që ato libra ti dhurojnë në bibliotekën e QKL. Në bazë të regjistrimit që disponon biblioteka, janë rreth 45 të mitur të regjistruar.<sup>54</sup>

Të miturit kryesisht shprehën se shkojnë herë pas here në bibliotekë por deklarojnë se biblioteka është e hapur vetëm një ditë në javë për vajzat dhe një ditë për djemtë (kryesisht e enjte dhe e premte). Ditët e tjera të javës ata tregojnë se e kanë të pamundur të drejtohen në bibliotekë për të tërhequr apo shkëmbyer libra.<sup>55</sup>

- Rekomandohet që biblioteka të furnizohet në mënyrë të rregullt nga MD, duke e pasuruar atë me botimet e fundit nga të gjitha seksionet për të përmbushur kërkesat dhe preferencat e të miturve në QKL.

## Gjendja psiko sociale e të miturve në QKL

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar monitorimit të gjendjes psikosociale të të miturve në QKL. Trajtimi tërësor i të miturve gjatë kohës që ata qëndrojnë në ambientet e QKL nuk nënkupton vetëm aplikimin e programeve dhe aktiviteteve në kuptimin e zbatimit të rregulloreve apo detyrave që institucioni dhe secili anëtar i stafit mund të ketë.

Në rradhë të parë dhe mbi të gjitha ai duhet të nënkuptojë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të tyre si fëmijë, mbrojtje e cila garantohet edhe me legjisllacionin në fuqi në Kosovë por edhe Konventat Ndërkombëtare. Puna efikase me fëmijët kërkon në fillim ndërtimin e një marrëdhënieje të

<sup>54</sup> Intervista me Koordinatorin e Programeve në QKL

<sup>55</sup> Intervista me të miturit në QKL

shëndetshme të besimit dhe respektit, përndryshe nëse ky raport nuk është i konsoliduar është shumë e vështirë të punosh për fazat e tjera të trajtimit profesional të të miturve, për të ndikuar sado pak në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre.

Gjatë vizitave monitoruese janë zhvilluar biseda dhe intervista me dhjetë të mitur prej të cilëve nëntë djem dhe një vajzë. Qëllimi i këtyre bisedave ka qënë marrja e këndvështrimit të tyre rreth kushteve në QKL, programeve të ofruara aty dhe trajtimit të tyre nga ana e stafit.<sup>56</sup>

## Kushtet higjienike

Në përgjithësi gjatë bisedave, të miturit shprehen se kanë nevojë për kushte më të mira të higjienës pasi herë pas here produktet higjienike mungojnë.<sup>57</sup> Kjo gjë konfirmohet edhe nga vetë drejtori i QKL i cili tregon se atëherë kur përfundon kontrata me furnizuesin, procesi i tenderimit, përzgjedhjes dhe kontratës me furnizuesin e ri mund të vonohet duke bërë që në QKL të krijohen vështirësi dhe produktet e higjienës të shpërndahen në mënyrë më të kufizuar tek të miturit.<sup>58</sup>

Dhomat janë të paisura me televizorë, mirëpo vetëm me tri programe televizive, gjë për të cilën të miturit kanë shumë ankesa. Në disa prej dhomave, transmetimi i këtyre programeve është i pamundur për shkak të problemeve teknike.

- Rekomandohet furnizimi i rregullt me produkte higjienike për të miturit. Poashtu, rekomandohet sigurimi i pakove televizive me programe të ndryshme edukative dhe argëtuese për të miturit.
- Inspektoriati shëndetësor duhet të inspektojë përbushjen e rregullave lidhur me ambientin fizik, higjienën, ushqimin, shërbimet mjekësore, sikundër edhe për shumë aspekte apo kushte të jetës institucionale që ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor të të miturve.

## Vizitat e familjeve për të miturit në QKL

I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.<sup>59</sup>

Të miturit janë vizituar nga prindërit, familjarët apo kujdestarët gjatë periudhës monitoruese, përveç rasteve të cilat familjet në pamundësi financiare nuk i kanë vizituar fëmijët e tyre. Rekomandohet të gjinden mundësi nga MD për të mbështetur transportin për familjet me vështirësi ekonomike.

56 Intervistat janë zhvilluar në periudhën monitoruese janar – qershor 2016 në QKL në Lipjan.

57 Intervistë me të miturit në QKL

58 Intervistë me drejtorin në QKL

59 Neni 120, Kodi i Drejtësisë për të Miturit

## Pushimet e të miturve

I mituri ka të drejtë në pushim ditor dhe javor në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. I mituri ka të drejtë në pushim vjetor prej tridhjetë (30) ditësh të cilat me leje të institucionit korrektues mund të shfrytëzohen edhe jashtë lokaleve të institucionit edukativ korrektues. Drejtori i institucionit edukativ korrektues të miturit mund t'i lejojë pushim shtesë nga institucioni edukativ korrektues për arsye edukative, profesionale, familjare ose arsye të tjera sociale deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë çdo vit.<sup>60</sup>

Të miturit e intervistuar kanë reflektuar pakënaqësi sa i përket dhënies së lejeve për të pushuar pranë familjes gjatë fundjavave. Edhe pse ekzistojnë disa kriteret të cilat në bazë të ligjit duhen plotësuar në mënyrë që të jepet leja për pushim gjatë fundjavës, ata shprehen se kanë shokë të tyre në pavione që i plotësojnë këto kriteret por që nuk u jepet pushimi në fundjavë dhe nuk ofrohen argumenta për këtë.<sup>61</sup>

Ndërkohë edhe vetë drejtori i QKL i referohet këtyre kriterëve gjatë procesit të vendimmarrjes për pushim. Ai thotë se një ndër kriteret që është shumë delikat në marrjen e vendimit, është ai i sigurisë së jashtme. Në anën tjetër drejtori i QKL thekson faktin se nëse i mituri shkon në pushim të fundjavës e nuk kthehet në QKL, kjo mbetet në përgjegjësi të drejtorit të QKL duke e konsideruar këtë si një çështje e cila duhet rishikuar. Ndërkohë ai tregon se çdo muaj rreth 10-15 të mitur shkojnë pranë familjes në fundjavë dhe çdo përgjigje jepet me shkrim.<sup>62</sup>

## Qëndrimi i të miturave femra në të njëjtin pavion me femrat e rritura

Sipas KDM, të dënuarit e mitur e mbajnë dënimin të ndarë nga madhorët.<sup>63</sup>

Një ndër shkeljet ligjore më të mëdha në QKL është qëndrimi i të miturave femra në të njëjtin pavion të femrave të rritura, të cilat janë të dënuara për vepra nga më të ndryshmet duke përfshirë vrasjen, prostitucionin dhe vepra tjera. Drejtori i QKL tregon se vendosja e vajzave të mitura në të njëjtin pavion me femrat e rritura është organizuar në këtë mënyrë për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme për ti ndarë ato.<sup>64</sup>

KOMF konsideron se kjo gjë, përveç se përbën një shkelje flagrante të të drejtave të fëmijëve, i dëmton të miturat, pasi qëndrimi në një ambient me femra të rritura të dënuara është krejtësisht i papërshtatshëm për to, jashtë kontekstit të moshës, zhvillimit dhe pjekurisë konjitive të të miturave.

Qëndrimi i vazhdueshëm në një ambient të tillë paraqet një rrezik të lartë për këto të mitura jo vetëm duke cënuar e dëmtuar përpjekjet për reintegrim të suksesshëm të të miturës në shoqëri, por madje edhe duke krijuar regres e përkeqësim të gjendjes së të miturës gjë e cila mund të rezultojë në gjymtim të thellë të zhvillimit të saj në përputhje me moshën dhe në këtë mënyrë dështim të gjithë sistemit korrektues.

60 Neni 121, Kodi i Drejtësisë për të Miturit

61 Intervistat me të miturit në QKL

62 Intervistë me drejtorin e QKL

63 Neni 182 (3) 3, Kodi i Drejtësisë për të Miturit

64 Intervistë me Drejtorin e QKL-së, z. Hestet Loku, janar 2016, Lipjan.

- Rekomandohet ndarja e të miturave nga femrat e rritura të dënuara, për të siguruar ambient të përshtatshëm për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturave me masa dhe atyre të dënuara.

## Dhuna e përdorur si mjet disiplinimi

Procedura disiplinore për të mitur me qëllim të disiplinimit dhe mbajtjes së rendit shtëpiak janë të ngjashme më ato të parapara për të burgosurit, por të përshtatura në atë formë që të mos prodhojnë efekt negativ për ta dhe në mirë të të miturve. Këto dispozita janë të parapara në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak. Të miturit shprehimisht janë të përjashtuar nga aplikimi i masave disiplinuese të cilat janë të papërshtatshme për të mitur, në këtë rast vetmia si masë disiplinore.<sup>65</sup>

Të gjithë të miturit e intervistuar rrëfejnë se kanë parë, kanë dëgjuar ose kanë qenë vetë protagonistë të episodeve të ushtrimit të dhunës brenda ambienteve të QKL. Ata tregojnë për raste të fyerjeve dhe abuzimit fizik nga oficerë korrektues apo mbikëqyrës pavionesh drejt të miturve si dhe për mbyllje të këtyre të miturve në dhoma të veçanta ku qëndrojnë të veltuar, pa zhvilluar aktivitetet rutinë dhe ku shëtitjet i bëjnë të vetëm e me kohë të reduktuar. Ata flasin për një izolim të të miturit nga të miturit e tjerë dhe dënim me mospjesëmarrje në rutina ditore dhe/ose aktivitete të reduktuara. Një prej të miturve rrëfen “U rrëzova nga karrika n’klasë dhe arsimtarja e thirri oficerin. Ai më çoj në banjo dhe më rreh”. Të miturit thonë se raste të tilla ka në vazhdimësi dhe përmendin episode të dhunës të ndodhura gjatë muajve të fundit “Mu për vete s’më kanë rreh por i di shokët e mi që i kanë rreh”.

Drejtori i QKL tregon se ankesat e të miturve për raste të dhunës janë shumë të rralla. Ai deklaron se në raste të ankesave të tilla ngihet një komision hetimor i cili heton rastin, merr në pyetje të miturin dhe stafin dhe merr masat e caktuara. Drejtori shprehet se komisioni është ad hoc, i përbërë nga tre anëtar të cilët zgjidhen nga vetë drejtori dhe janë po ashtu pjesë e QKL. Për ndonjë rast të jashtëzakonshëm, drejtori ka të drejtë të kërkojë një komision hetimor të jashtëm.

Komf rekomandon QKL, të sigurojë që të gjitha masat disiplinore të cilat paraqesin trajtim të vrazhdë, çnjerëzor apo degradues të ndalohen rigorozisht, përfshirë dënimin me rrahje, izolimin apo vetminë apo ndonjë ndëshkim tjetër që mund të rrezikojë shëndetin fizik apo mendor të të miturit. Disiplinimi gjithmonë duhet të shihet si mjet arsimor dhe nxitës i vetërespektit të të miturve në përgatitje për kthim në familje dhe komunitet, dhe nuk duhet t’u imponohet atyre si sanksion disiplinor.

- KOMF rekomandon aktivizimin e Inspektoriatit të MD apo autoriteteve të tjera të cilat nuk i takojnë administratës së QKL, të zhvillojnë inspektime në baza të rregullta dhe ndërmarrjen e inspektimeve të paparalajmëruara. Trupi inspektues duhet të gëzojë garanci të plotë të pavarësisë në ushtrim të funksionit të tij. Inspektorët duhet të kenë qasje të papenguar tek të gjithë personat e punësuar në QKL dhe të miturit me masa edukative, të miturit e dënuar dhe ata të paraburgosur. Çdo i mitur duhet të ketë të drejtën që në konfidencë të bisedojë me zyrtarin inspektues.
- Inspektoriat duhet të dorëzojë raportin me konstatimet e tij. Raporti duhet të përfshijë vlerësimin e përmbushjes së obligimeve nga ana e QKL bazuar në legjislacionin në fuqi dhe standardet

65 Neni 122, Kodi për Drejtësi për të Mitur

ndërkombëtare, dhe rekomandimet lidhur me hapat që duhet ndërmarrë për të siguruar zbatimin e dispozitave në fjalë. Çdo fakt i zbuluar nga inspektoriati që nënkupton shkelje të dispozitave ligjore lidhur me të drejtat e të miturve apo funksionimin e QKL, duhet t'i komunikohet autoritetit kompetent për hetim dhe ndjekje penale.

## Sistemi i ankesave në QKL

Sistemi i ankesave është i rregulluar me Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 ka patur vetëm dy ankesa nga të miturit për çështje të ndryshme, të cilat janë shqyrtuar.<sup>66</sup> Të gjithë të miturit e intervistuar kanë shprehur dukshëm një mungesë të përgjithshme të besimit për të shprehur shqetësimet apo pakënaqësitë e tyre. Në pavione ekziston kutia e ankesave ku ata në mënyrë anonime mund të parashtrojnë ankesat e tyre. Kutia e QKL hapet çdo javë nga zëvendës drejtoresha e QKL. Të miturit thonë se nuk kanë besim në sistem të ankesave dhe se kërkesat e tyre në përgjithësi nuk merren parasysh.

- KOMF rekomandon që çdo i mitur i cili pretendon që i janë shkelur të drejtat apo ka qenë viktimë e dhunës, duhet të ketë të drejtë për të kërkuar ndihmë nga mbrojtësit e viktimave.
- KOMF rekomandon që kutia e ankesave e QKL të hapet në prani të një zyrtari të Inspektoriatit në kuadër të MD. Kjo ndikon në rritje të besueshmërisë së të miturve në sistem të ankesave.

## Organizimi i stafit në QKL

Në QKL janë të punësuar 135 zyrtarë korrektues me uniformë, përderisa 27 janë staf civil, përfshirë drejtorin e QKL. Në kuadër të stafit civil, stafi profesionist që punon me të miturit është i përbërë nga: dy punëtorë sociale, një psikologe, 8 punonjës shëndetësor dhe një koordinator i programeve.

Konstatohet numër i madh i zyrtarëve korrektues dhe numër i vogël i stafit profesionist. Duke qenë se masat edukative kanë për qëllim të kontribuojnë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste, stafi profesionist është kuadri i cili është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe realizimin e programeve për rehabilitim dhe reintegrim të të miturve.

66 Intervistë me drejtorin e QKL



Prandaj, për të arritur qëllimin për të cilin jepen këto masa edukative, rekomandohet fuqishëm rritja e numrit të stafit profesionist (me fokus të veçantë punësimin e edukatorëve të cilët mungojnë tërësisht në QKL). Përndryshe, organizimi aktual i QKL ka synim primar sigurinë (pengimin e ikjes së të miturve) duke lënë pas dore punën në rehabilitim, edukim dhe reintegrim të të miturve, që përbën edhe qëllimin e dhënies së masave. Stafi në QKL këtë e arsyeton, pasi ata mbajnë përgjegjësi direkte në rast të ikjes së të miturve nga QKL.

- Rekomandohet që QKL të ketë staf shtesë të kualifikuar dhe të ketë numër të mjaftueshëm të specialistëve si edukatorë, punëtorë socialë, psikologë, instruktorë profesional, këshilldhënës, psikiatër. QKL duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore për të zbatuar programet individuale, programet rehabilituese dhe reintegruese, programet edukative dhe të tjera si dhe format e tjera të ndihmës të cilat janë adekuate në përputhje me nevojat individuale të të miturve me masa edukative dhe atyre të dënuar.
- Rekomandohen trajnime periodike të vazhdueshme për stafin në QKL që u mundësojnë atyre të përmbushin përgjegjësitë në mënyrë efikase, në veçanti në lëminë e psikologjisë së fëmijëve, mirëqenies së fëmijëve dhe standarteve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe të drejtat e të miturve me masa edukative dhe atyre të dënuar.

## Perceptimi i stafit të QKL për institucionin e ri edukativo korrektues

Stafi shëndetësor ka perceptim shumë pozitiv për institucionin e ri edukativo korrektues dhe shprehet se ky institucion do të ndikojë në mënyrë pozitive tek të miturit. Stafi shëndetësor nuk ka informacion se si ata do të organizohen në qendrën e re edukative korrektuese, por pohon se për këtë çështje sigurisht se do të informohet nga MSH.<sup>67</sup> Të njëjtin qëndrim mban edhe psikologjia e Ambulancës së QKL. Ajo shprehet se hapja e institucionit të ri do të ndikojë dukshëm në rritjen e cilësisë së shërbimit psikologjik që do të ofrohet aty për shkak të uljes së numrit të përfituesve.<sup>68</sup>

Për dallim, stafi arsimor është skeptik për zhvillimin e procesit mësimor jashtë ambienteve të QKL. Ata shprehen se në mënyrë që vijimi i mësimit të jetë cilësor, paraprakisht duhet punuar në vetëdijësim të shkollave publike dhe komunitetit dhe gjithashtu duhen mbajtur trajnime specifike e të vazhdueshme për stafin që punon me të miturit.<sup>69</sup>

Koordinatori i Programeve në QKL shprehet se në vitin 2012 mësimi nga të miturit është mbajtur në shkollat publike jashtë institucionit të QKL por shkollat kanë deklaruar se komuniteti përreth është i shqetësuar që fëmijët e tyre e ndjekin mësimin me të miturit që vijnë nga QKL duke u shprehur edhe me terminologji stigmatizuese e diskriminuese për të miturit. Sipas vetë Koordinatorit të Programeve në QKL, veç komunitetit kanë qenë edhe vetë shkollat me drejtoritë përkatëse që i kanë paragjykuar të miturit dhe nuk kanë arritur ti përfshijnë e integrojnë si të barabartë me nxënësit e tjerë.<sup>70</sup>

67 Intervistë me mjeken përgjegjëse në QKL

68 Intervistë me psikologun në QKL

69 Intervistë me arsimtarët në QKL

70 Intervistë me Koordinatorin e Programeve në QKL

Përderisa, zyrtarët korrektues janë të ndarë në dysh rreth kësaj çështjeje. Zyrtarët korrektues të cilët kanë qenë pjesë e QKL para vitit 2000 (atëherë kur QKL është quajtur Shtëpi Edukuese Korrektuese, ka funksionuar si institucion i tipit gjysmë të hapur), deklarojnë që të miturit deri në vitin 2000 kanë ndjekur procesin arsimor në shkollë të rregullt brenda QKL dhe ky proces ka shkuar mjaft mirë. Zyrtarët korrektues përmendin me nostalgji rolin dhe punën e madhe të edukatorëve me të miturit. Ata shprehen që mbyllja e derës elektrike dhe uniforma e zyrtarit korrektues nuk mund të edukojë të miturit.<sup>71</sup>

Ndërsa zyrtarët korrektues të punësuar pas vitit 2000 shprehen skeptik sa i përket funksionimit të qendrës së re korrektuese, për faktin që institucioni i ri parashihet të jetë i tipit të hapur dhe gjysmë të hapur, dhe sipas tyre të miturit do të ikin nga kjo qendër.

Drejtori i QKL deklaron që organizimi në qendrën e re korrektuese nuk është akoma i qartë, por e pranon që fillimi i funksionimit të qendrës do të jetë me shumë sfida, duke pasur parasysh që qendra do të funksionojë si një institucion i tipit të hapur dhe gjysmë të hapur. Drejtori akoma nuk e ka te qartë se si do të bëhet transferimi i të miturve në qendrën e re. Ai propozon që transferimi të bëhet gradualisht, duke transferuar fillimisht të miturit që kanë sjellje më të mirë.

Gjatë intervistave të ekipit të KOMF me të miturit në QKL, të miturit në vazhdimësi kanë bërë pyetjen se kur do të fillojë funksionimi i qendrës së re dhe rrjedhimisht edhe transferimi i tyre në qendrën e re.<sup>72</sup> Të miturit tashmë janë në dijeni që qendra e re do të jetë e tipit të hapur dhe gjysmë të hapur dhe për këtë të miturit janë shumë të ngazëlyer. Pëderisa një pjesë e të miturve nuk mund të besojnë që qendra e re do të jetë e tipit të hapur dhe gjysmë të hapur, duke e quajtur si diçka shumë të mirë dhe të pabesueshme për të ndodhur.

---

71 Intervistë me shefen e pavionit të femrave të dënuara

72 Intervistë me të miturit në QKL

## REKOMANDIME

### Rekomandim emergjent

- Rekomandohet fuqimisht iniciimi i një procesi hetimor rreth deklaratave të të miturve mbi përdorimin e dhunës si mjet disiplinimi, nga stafi i QKL.

### Rekomandimet për plotësim ndryshimin e KDM

- Afati i paraburgimit për të miturit prej 6 muajve me mundësi zgjatjeje deri në një vit është në kundërshtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Kjo bëhet dhe më shumë e papranueshme për të miturit pasi që paraburgimi nuk kalkullohet në kohëzgjatjen e masës. KOMF rekomandon që afati 6 muaj me mundësi zgjatjeje dhe për 6 muaj tjerë, duhet të ndryshohet duke përcjellë praktikat e vendeve me sistem të avancuar të drejtësisë për të mitur, ku paraburgimi mund të zgjasë 3 muaj me mundësi zgjatjeje më së shumti edhe për 3 muaj të tjerë, në qoftë se kjo paraqitet e nevojshme për arsyet e parapara nga KDM.
- Rekomandohet që në plotësim ndryshimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur të parashihen dispozita ligjore për llogaritjen e paraburgimit në kohëzgjatjen e masës.
- Rekomandohet që në plotësim ndryshimin e KDM, të parashihet grupi edukativ prej më së shumti 10 të mitur në raport me një edukator. Rekomandohet punësimi i edukatorëve për të mitur në institucionin e ri si dhe krijimi i grupeve edukative.

### Rekomandime për gjyqtarë

- Rekomandohet realizimi i vizitave nga gjyqtarët tek të miturit çdo gjashtë (6) muaj, për të përcjellë trajtimin e të miturve dhe për të vlerësuar nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme. Rekomandohet që në kuadër të plotësim ndryshimit të KDM, të parashihet që në rast të çfarëdo të mete apo vërejtjeje, gjyqtari kompetent për të mitur, duhet të informojë ASHK dhe Inspektoriatin në kuadër të MD.
- Numri i rasteve të vonuara në ekzekutimin e dënimeve me masa edukuese korrektuese kur të miturit janë sjellë në vuajtjen e masës pas moshës madhore, është i madh. Rekomandohet ndalimi i shqiptimit të masave mbi masë sepse e dëmton në masë të madhe risocializimin dhe reintegrimin e të miturve.
- Rekomandohet bashkëpunimi i gjykatëseve me zyrtarët provues dhe me zyrtarët në QKL.

## Rekomandime për institucionin për të miturit me masa edukative

- Rekomandohet domosdoshmërisht zhvillimi i programeve individuale të përshtatura me gjendjen, zhvillimin psikik dhe atë fizik të secilit të mitur, në pajtim me KDM. Programet individuale duhet të përmbajnë objektivat për të miturit për të siguruar rehabilitimin, edukimin, ndryshimin e sjelljeve dhe reintegrimin e të miturve. Programet duhet të hartohen nga ekipi multidisiplinar, ku përpos punëtorit social përgjegjës, kërkohet edhe përfshirja e psikologut, zyrtarit sprovues, edukatorit, të miturit, prindërve apo kujdestarëve dhe institucioneve të tjera relevante.
- Rekomandohet krijimi i programeve edukative dhe rehabilituese për të miturit. Kjo do të ndikonte ndjeshëm që ata të mos kryenin sërish shkelje, duke reduktuar kështu dukurinë e recedivizmit dhe duke dëshmuar në këtë mënyrë sukses të shërbimit korrektues në tërësi.
- Rekomandohet krijimi i kushteve për vijimin e mësimi jashtë institucionit edukativ korrektues, në shkolla të rregullta publike.
- Rekomandohet krijimi i mundësisë dhe kushteve që të miturit të kenë mundësi të kryerjes së punës me shpërbim, në rast se është e mundur në komunitet, si plotësim i trajnimit profesional për rritjen mundësive për punësim adekuat pas kthimit në familje dhe komunitet.
- Rekomandohet shtimi i kurseve të tjera që janë atraktive për të miturit, që nxisin zhvillimin e aftësive dhe kreativitetin tek të miturit dhe ndihmojnë në rehabilitimin dhe reintegrimin e tyre. Kurse të tilla mund të jenë të karakterit artistik si për shembull kurse për pikturë, për aktrim apo ato të karakterit sportiv.
- Rekomandohet ndarja e të miturve nga femrat e rritura të dënuara, për të siguruar ambient të përshtatshëm për rehabilitimin dhe re integrimin e të miturve me masa dhe atyre të dënuara.
- Rekomandohet ndarja e objekteve për të miturit të dënuar dhe për ata të paraburgosur;
- Institucioni duhet të sigurojë që të gjitha masat disiplinore të cilat paraqesin trajtim të vrazhdë, çnjerëzor apo degradues të ndalohen rigorozisht, përfshirë dënimin me rrahje, izolimin apo vetminë apo ndonjë ndëshkim tjetër që mund të rrezikojë shëndetin fizik apo mental të të miturit. Disiplinimi gjithmonë duhet të shihet si mjet arsimor dhe nxitës i vetërespektit të të miturve në përgatitje për kthim në familje dhe komunitet, dhe nuk duhet t'u imponohet atyre si sanksion disiplinor.
- Personeli duhet të pranojë trajnime periodike të vazhdueshme të tilla që u mundësojnë atyre të kryejnë përgjegjësitë në mënyrë efikase, në veçanti në lëminë e psikologjisë së fëmijëve, mirëqenies së fëmijëve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe të drejtat e të miturve me masa edukative dhe atyre të dënuar.

## Rekomandime për MD

- Rekomandohet zbatimi i dispozitave të KDM, duke krijuar objekt të tipit të hapur dhe gjysmë të hapur për të miturit me masë edukative. Objekti i tillë duhet të ketë kushte sigurie minimale apo të jetë fare pa to.
- Rekomandohet nxjerrja e një akti nënligjor nga MD, lidhur me programin për të miturit me masë edukative në institucion të tipit të hapur dhe gjysmë të hapur.
- Rekomandohet punësimi i stafit të kualifikuar dhe të ketë numër të mjaftueshëm të specialistëve si edukatorë, punëtorë socialë, psikologë, instruktorë profesional, këshilldhënës, psikiatër. Duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore për të zbatuar programet individuale, programet rehabilituese dhe reintegruese, programet edukative si dhe format e tjera të ndihmës të cilat janë adekuate në përputhje me nevojat dhe problemet individuale të të miturve me masa edukative dhe atyre të dënuar.

- Rekomandohet që MD të vazhdojë me trajnimin dhe profesionalizimin e stafit të QKL bazuar në nevojat e identifikuar;
- Rekomandohet aktivizimi i Inspektoriatit të MD apo autoriteteve të tjera të cilat nuk i takojnë administratës së QKL, të zhvillojnë inspektime në baza të rregullta dhe ndërmarrjen e inspektimeve të paparalajmëruara. Çdo fakt i zbuluar nga inspektoriatit që nënkupton shkelje të dispozitave ligjore lidhur me të drejtat e të miturve apo funksionimin e QKL, duhet t'i komunikohet autoritetit kompetent për hetim dhe ndjekje penale.
- Rekomandohet të gjinden mundësi nga MD për të mbështetur transportin për familjet me vështirësi ekonomike, në mënyrë që të realizojnë vizitat tek të miturit dhe të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e programeve individuale të të miturve.
- Rekomandohet që biblioteka të furnizohet në mënyrë të rregullt nga MD, duke e pasuruar atë me botimet e fundit për të përmbushur kërkesat dhe preferencat e të miturve në QKL dhe në institucionin e ri.

### Rekomandime për MSH

- Rekomandohet që të bëhet një vlerësim për nivelin e knaqshmërisë së të miturve në marrjen e shërbimit shëndetësor gjatë vitit 2015 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2016. Ky vlerësim do të siguronte informacionin e nevojshëm për të përcaktuar ndërhyrjet për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e cilësisë.
- Rekomandohet furnizimi i rregullt me të gjitha barnat nga lista esenciale e barnave, aq më shumë duke pasur parasysh ndjeshmërinë e rasteve. QKL nuk duhet të ketë mungesë të barnave nga lista esenciale dhe duhet të jetë gjatë gjithë kohës e furnizuar me to.
- Rekomandohet sigurimi i një autoambulance për rastet emergjente të të miturve paraqet vështirësi, atëherë kur ato duhet të transportohen në institucione shëndetësore më të specializuara.
- Inspektoriatit shëndetësor duhet të inspektojë përmbushjen e rregullave lidhur me ambientin fizik, higjienën, ushqimin, shërbimet mjekësore, sikundër edhe për shumë aspekte apo kushte të jetës institucionale që ndikojnë në shëndetin fizik dhe mendor të të miturve.

